

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) neni 52 të Ligjit për veprimtari shkencore-hulumtuese (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 46/08, 103/08, 24/11, 80/12, 24/3, 147/13, 41/14, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 53/16) dhe neni 4 të Rregullores për mënyrën dhe procedurën për financimin, krijimin dhe avancimin e kuadrove shkencore-hulumtuese (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 18/12, 64/13, 98/13, 70/14, 88/14, 74/15, 140/15 dhe 178/15) Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall

PLOTËSIM TË KONKURSIT

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDIME AKADEMIKE TË CIKLIT TË DYTË JASHTË VENDIT PËR VITIN AKADEMIK 2021/2022

Në Konkursin për ndarjen e bursave për studime akademike të ciklit të dytë jashtë vendit për vitin akademik 2021/2022 nr. 15-4427/1 të datës 09.03.2021 në pjesën **V. MËNYRA DHE AFATI I APLIKIMIT** shtohet paragrafi i ri i cili thotë: „ Njoftohen kandidatët se Fletë aplikimi i kompletuar dhe dokumentacioni mund të dorëzohet edhe vetëm në formën elektronike në: <https://e-uslugi.mon.gov.mk/>“.